



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Ae.nr.102/20

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Ekonomike, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Liridon Maloku, kryetar i kolegjit, Mahir Tutuli dhe Rustem Thaqi, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses [“B...”] sh.p.k. me seli në Fushë Kosovë, të cilën e përfaqëson me autorizim avokati [N.S] nga Prishtina, kundër të paditurës Dogana e Kosovës, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson me autorizim [XH.K], për kompensim dëmi, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike IV.EK.nr.490/17 i datës 10/03/2020, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën **22/06/2021**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pa themeltë ankesa e të paditurës Dogana e Kosovës, me seli Prishtinë dhe **VËRTETOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike IV.EK.nr.490/17 i datës 10/03/2020.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktgjykimin ankimor IV.EK.nr.490/17 i datës 10/03/2020, ka vendosur si vijon:

I.Aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditëses [“B...”] me seli në Fushë Kosovë, e paraqitur kundër të paditurës Dogana e Kosovës, me seli në Prishtinë, ashtu që detyrohet e paditura që në emër të kompensimit të demit material për shkak të mallit të shkatërruar t’ia kompensoj shumen prej 7,816.21 euro, në emër të kompensimit të shpenzimeve të shkatërrimit të mallit t’ia kompensoj shumen prej 331.00 euro, ndërsa në emër të kompensimit të demit në formë të fitimit të humbur t’ia kompensoj shumen prej 1,563.24 euro në shumen e përgjithshme prej 9,711.00 euro, me kamatë prej 8% në vit, duke llogaritur nga data e parashtrimit të padis ne

gjykate dt.27.10.2017 e deri në pagesën definitive, brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimi.

II.Detyrohet e paditura, që paditëses, t'ia paguaj shumën prej 1,892.00 euro, në emër të kompensimit të shpenzimeve të procedurës kontestimore, brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi, e paditura në afatin ligjor ka paraqitur ankesë për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa si e bazuar dhe të prishet aktgjykimi i atakuar dhe të refuzohet kërkesëpadia apo çështja të kthehet Gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Paditësja nuk ka dhënë përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195, dhe 200 të LPK-së, ka gjetur se:

-Ankesa është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja ["B..."] me seli në Fushë Kosovë, pranë Gjykatës Themelore Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me datën 27/10/2017, ka paraqitur padi kundër të paditurës Dogana e Kosovës, me seli në Prishtinë, për kompensim dëmi, me kërkesë të precizuar si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar, me të cilën e ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë, duke arsyetuar se paditësja ka importuar sasi të caktuar të mallrave, ashtu që këto mallra i ka deklaruar te e paditura për doganim dhe kjo e fundit e ka caktuar vlerën e re doganore, për të cilën paditësja nuk është pajtuar dhe ka paraqitur kërkesë për rishqyrtimin e vendimeve ... dhe ... te e paditura e cila një kërkesë të tillë e ka refuzuar si të pa bazuar, mirëpo paditësja kundër këtij akti administrativ ka iniciuar konfliktin administrativ dhe Gjykata Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative, me aktgjykimin A.nr.2396/14 ka vendosur që të aprovon kërkesëpadinë e paditëses si të bazuar dhe ka anuluar vendimin e të paditurës. E paditura në ri procedurë e ndërpre në procedurën e iniciuar nga

paditësja me arsye se mallit i ka skaduar afati dhe është asgjësuar, ndërsa me ekspertizë financiare është vërtetuar vlera e mallit në lartësi prej 7,816.21 euro, fitimi i humbur në lartësi prej 1,563.24 euro dhe shpenzimet e asgjësimit në shume prej 331.80 euro apo gjithsejtë 9,711.25 euro. Mbi bazën e kësaj gjendje faktike gjykata e shkallës së parë ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar, duke u bazuar në nenin 136, nenin 138, nenin 173 dhe nenin 382.1 të LMD-së, ndërsa vendimin mbi shpenzimet e procedurës e ka marr konform nenit 452.1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit i pathemeltë qëndron pretendimi ankimor i palës ankuese për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, ngase aktgjykimi i ankimuar del se nuk është i përfshirë në të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet sepse dispozitivi i aktgjykimit është i qartë e në harmoni të plotë me arsyetimin e aktgjykimit. Në arsyetim të aktgjykimit po ashtu janë dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha faktet vendimtare të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë, e sipas të cilave edhe është vendosë lidhur me themelësinë e kërkesëpadisë. Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsyeje të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre.

Gjykata e Apelit nuk i ka pranuar pretendimet e të paditurës për gjendjen faktike të konstatuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë nga ana e gjykatës së shkallës së parë sepse me provat e administruara u vërtetua bindshëm baza juridike e kërkesëpadisë se deri te shkaktimi i dëmit ka ardhur si rezultat i veprimeve kundër ligjore të paditurës e cila ka bërë vlerësimin e DUD-av të mallrave që i ka importuar paditësja. Kjo gjendje faktike është vërtetuar me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative A.nr.2396/14 e datës 14/02/2017, ku është anuluar vendimi i të paditurës mbi vlerësimin e mallit dhe çështja është kthyer në rivendosje. E paditura me aktvendimin e datës 07.03/1665/2014 e datës 27/09/2017 ka marr vendim dhe e ka ndërprerë procedurën për shkak se malli është asgjësuar, që nënkupton se e paditura në procedurën e rivendosjes nuk ka arritur të provon se ka vepruar në harmoni me

legislacionin vendor me rastin e vlerësimit të mallit të paditëses. Mandej, ndërmjet palëve ndërgjyqëse nuk ishte kontestuese se malli i paditëses që ka qenë i ndaluar nga e paditura është asgjësuar dhe kjo vërtetohet përmes procesverbalit të lëshuar nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinarisë-Inspektoriati Sanitar i Kosovës nr. ... të datës 27/07/2016.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallë së parë me të drejtë ka vepruar kur ka vendosur që t'ia fal besimin ekspertizës financiare të punuar nga eksperti Dr.[V.I], me të cilën është vërtetuar bindshëm lartësia e kërkesëpadisë në shumë prej 9,816.21 euro, e ndaj të cilës ekspertizë e paditura nuk ka paraqitur ndonjë kundërshtim të bazuar në prova material dhe në këtë drejtim nuk kishte pretendime ankimore, pastaj janë shqyrtuar edhe pretendimet tjera të paditurës, por të njëjtat janë vlerësuar si të pa bazuar sepse në shkresat e lëndës nuk ka ndonjë provë materiale që vërteton se e paditura ia ka mundësuar paditëses tërheqjen e mallit me pagimin e taksës doganore-jo kontestuese, kur kihet parasysh se malli përkatës ka qenë me afat të caktuar të përdorimit. Sipas nenit 7.1 të LPK-së është paraparë: *Palët kanë për detyrë të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla*, ndërsa neni 319.1 të po këtij ligji ka paraparë: *Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provoje faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta* ndërsa neni 322.3 i po këtij ligji ka paraparë: *Pala e cila e konteston ekzistimin e ndonjë të drejte e bartë barrën e të provuarit të faktit që e ka penguar krijimin apo realizimin e saj, ose në bazë të të cilit ka pushuar se ekzistuari, po që se ligji nuk parasheh diç tjetër.*

Nga një gjendje e tillë faktike e konstatuar dhe vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë, rezulton se baza juridike e kërkesëpadisë, që e paditura të jetë përgjegjëse për të kompensuar dëmin paditëses, gjënë mbështetje në nenin 136, nenin 140, nenin 169 dhe nenin 173 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimit i datës 10 Maj 2012, i cili ka hyrë në fuqi nga data 20 Dhjetor 2012. Me nenin 136 të LMD-së, përcaktohet se: “Kush i shkakton tjetrit dëm, ka për detyrë ta kompensoj, përveç nëse vërtetohet se dëmi është shkaktuar pa fajin e tij”, me nenin 140 të këtij ligji, përcaktohet se: “Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje ose nga pakujdesia, mandej me nenin 169 është paraparë: Personi përgjegjës ka për detyrë ta rivendosë gjendjen e cila ka qenë para se të shkaktohet dëmi ndërsa me nenin 173 përcaktohet se: “I dëmtuari ka të drejtë si për shpërblimin e dëmit të rëndomtë, ashtu edhe për shpërblimin e fitimit të humbur. Në kuptim të këtyre dispozitave rezulton se gjykata e shkallës së parë me të drejtë e ka gjetur si të themeltë bazueshmërinë e kërkesëpadisë së paditëses.

Janë vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore, por Gjykata e Apelit nuk ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, që do të ndikonte në ligjshmërinë e aktgjykimit, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti së gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 paragrafi 1 pika (d) e lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
-Departamenti për Çështje Ekonomike-
Ae.nr.102/20, me datën 22/06/2021

Kryetari i kolegjit-Gjyqtari
Liridon Maloku